



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Lënda: Procesverbal i mbledhjes 31.08. 2022.

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion për miratim procesverbalin e mbledhjes së datës 31.08. 2022.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot në datë 31.08. 2022 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastrë. Mbledhja po zhvillohet në ambientet e hotel “Çajupit”.

Marrin pjesë në mbledhje 23 anëtarë. Mungojnë në mbledhje; Kallajnxhi, Feruni, Arapaj, Xheko, Sufati, Qeli, Rova , Hasko.

Hapet mbledhja nga Z. Lavdi Hasani. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Z. Lavdi Hasani lexon rendin e ditës me 1 pikë shtesë.

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 04.08.2022.
2. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin **01-31.08. 2022**”.
3. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **01-31.08. 2022**”.
4. P/Vendim “Për dhënien e sipërfaqeve të tokave bujqësore me qira ”.(Irikthyer nga prefektura për plotësim dokumentacioni)
5. Raport i Drejtorisë së Arsimit për masat e marra për fillimin e vitit shkollor 2022-2023.
6. Të ndryshme (Kërkesa e familjes së zotit Skifter Murataj)
7. P/Vendim “Për një ndryshim në Vendimin nr.53, datë 05.07.202 “ Mbi sistemimin e 5% të garancisë së punimeve, për të cilat ka kaluar afati i marrjes në dorëzim të certifikatës së përhershme të objektit dhe kalimit në të ardhurat e bashkisë me qëllim përdorimin e tyre në interes publik”.

Shprehet për rendin e ditës Z.Petrit Brahim: Të diskutohet te të ndryshme shërbimi urban në lagjen “Cfakë “ , si dhe kërkesat e qytetarit për zhurmat në Pazar, dhe pagesa e punonjësve të komunaes, për shtesë rroge.

Miratohet rendi i dites dhe dy procesverbalet e mbledhjes së datës 04.08.2022 dhe mbledhjes jashtë radhe datës 11.08.2022 me 23 vota pro.

Z. Hasani lexon kërkesën e familjes së z. Murataj : Pasi kemi parë kërkesën dhe kemi diskutuar me ekzekutivin për mënyrën e zgjidhjes së këtij problemi ju informoj se ju keni marrë me vendim të Këshillit Bashkiak një shumë prej 200.000 lekë . Buxheti për 2022 është i miratuar dhe vetëm kaq mund të jepej . Duke u mbështetur në të drejtat që na jep ligji i propozojmë ekzekutivit që për buxhetin e vitit 2023 të parashikojë ndihmën deri në 50% të preventivit të dëmit të shkaktuar.Ti kthehet përgjigje qytetarit bazuar në bazën ligjore përkatëse.

Largohen nga mbledhja me leje Rexhaj, Llogo.

Miratohen me 21 vota pro P/Vendim “ Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin **01-31.08. 2022**”.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **01-31.08. 2022**”.

Hidhet në votë dhe miratohet me 21 vota pro P/Vendim “Për dhënien e sipërfaqeve të tokave bujqësore me qira ”.(Irikthyer nga prefektura për plotësim dokumentacioni). Paraqiten para këshilltarëve hartat në A 3.

Lexohet nga z. Hasani pika shtesë. P/Vendim “Për një ndryshim në Vendimin nr.53, datë 05.07.202 “ Mbi sistemimin e 5% të garancisë së punimeve, për të cilat ka kaluar afati i marrjes në dorëzim të çertifikatës së përhershme të objektit dhe kalimit në të ardhurat e bashkisë me qëllim përdorimin e tyre në interes publik”.

Z. Brahimi: Unë jam pro për rrugën e Zhulatit, por me lote, atë që ndërtojmë sot na prishet nesër. Nuk jam dakord. Emergjencat Civile nuk kanë dhënë një lek për Gjirokastrën, nuk kanë ndërtuar një m rrugë, nuk i kanë fondet për Korçën, nuk është bërë një rrugë rurale ende.Unë mendoj të mos heshtim, sepse të gjitha investimet janë fituar me projekte të bëra nga ekzekutivi, dhe propozoj një takim me deputetët e qarkut tonë sepse i kemi dhënë shumë kësaj qeverie.

Z. Armand Hilaj: Të qartësojmë pak rastin e familjes Murataj se mos hapim lojën se ka plot raste të tjera.Jam dakord për rrugën e “ Zhulatit”.

Sqaron edhe znj. Albana Allushaj në lidhje me mundësitë që i jepen familjes nëse aplikon për strehim social ku 20% jepen nga bashkia dhe 85% nga Shërbimi Social Shtetëror.

Sqaron bazën ligjore ku mbështeten familjet deri në 50% të shumës sipas preventivave të dëmit të shkaktuar znj. Artiste Koko. Kjo gjë bazohet në VKM Nr. 329 dhe VKM. Nr.414 dhe ligjin nr 45 për “Emergjencat Civile”. Lekët i kalojnë buxhetit të bashkisë si transfertë e kushtëzuar . Është viti i parë që po gjen zbatim.

Përsa i përket rrugës së Zhulatit është e planifikuar në 3 vite.

Ne si ekzekutiv paraqitëm 2 projekte për EC dhe në dy fazat e para u shpallëm fitues, por humbëm në fazën e tretë dhe nuk morëm fonde nga pushteti qëndror, kështu që do të vazhdojmë planifikimin me fondet tona.

Z. Karagjopzi: A është provizor investimi apo ajo pjesë që do të bëhet do të përfundohet me të gjitha parametrat?

Z. Brahimi: Të kërkohet takim me Ministrinë e Mbrojtjes.Është detyrë e Emergjencave Civile. Kërkoj takim me deputeten dhe Ministrinë e Mbrojtjes.

Z. Hasani: Rruga e Zhulatit të mendohet mirë.

Z.Nertil Nebiaj: Për planin e tregut projekti është gati dhe do të aplikojmë te Ministria e Bujqësisë për këtë gjë.

Znj. Florika Qafzezi: Pas miratimit, kur fillon puna, se po afron dimri?

Hidhet në votë dhe miratohet me 19 vota pro, një kundër, Z.Petrit Brahimi, dy abstenim Znj. Karolina Xheko dhe Z. Neim Nebiaj.

Diskutohet Raporti i Drejtorisë së Arsimit.

Z. Naçi: E lexova raportin dhe kam fjalë të mira për punën e bërë me shkollat.

A mund të shtrihet edhe në shkolla të tjera projekti i paneleve diellore ?

Si është gjendja e internetit në shkolla dhe a keni marrë masa për ngrohjen në stinën e dimrit?

Znj. Florika Qafzezi: Sa shkolla kemi me kaldajë dhe sa me ngrohje me dru? A keni informacion për prurjet e nx për këtë vit?

Znj. Dorina Demo: Ju falënderoj për mbështetjen dhe fjalët e mira.Ju informoj se këtë verë që pamë funksionimin e paneleve te shkolla "Koto Hoxhi", rezultati ishte shumë i mirë dhe kemi në plan të hartojmë projekte të tjera.Në raport nuk i kemi përfshirë masat për stinën e dimrit por i kemi marrë masat dhe e kemi lëndën djegëse për të gjitha shkollat që kemi me kaldajë. Vetëm dy shkolla dhe një kopsht kemi me ngrohje me dru dhe i kemi marrë masat.

Përsa i përket internetit, AMU mbulohet nga bashkia, kurse AML nga MAS-i

Z. Hasani: Kam një sygjërim për zonën e pazarit, duhet menduar për sipërfaqe gjelbërimi dhe rekreative në këtë zonë sepse ka nevojë dhe mund të gjendet mundësia.

Z. Arqile Zhapa: Mendoj që pazari e ka marrë gjallërinë, por mos harroni se banorët rezidentë janë më shumë në lagjen "18Shtatori", dhe duket sikur po paguan kostot e pazarit.Prandaj të zhvillohen aktivitete edhe në pjesën e poshtme të qytetit.

Z. Vladimir Naçi: Shqetësim qentë në lagjen "Varrosh"dhe pranë shtëpisë së Kadaresë të shikohen koshat se ndotin rrugën. Pusetat në lagjen tonë bien erë të rëndë, duhet zgjidhur problemi.

Z. Hasani: Të zgjidhet problemi i urbanit të lagjes "Cfakë"

Mbyllet mbledhja nga z. Hasani në orën 12:52

Sekretar

Etleva Yzo

Kryetar i Këshillit

Laydi Hasani

